



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Tiranë, me 16 . 03 . 2022

Dokument parlamentar

V E N D I M

Nr. 7/2022

**PËR SHPALLJEN E VAKANCËS SË DY ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES
TË RADIOTELEVISIONIT SHQIPTAR**

Në zbatim të nenit 93, pika 2 dhe nenit 94, të ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe nenit 34 të Rregullores së Kuvendit,

KOMISIONI PËR EDUKIMIN DHE MJETET E INFORMIMIT PUBLIK

V E N D O S I:

- I.** Shpalljen e dy vendeve vakante për anëtarë të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.
- II.** Të ftohen për paraqitjen e kandidaturave për anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH-së, subjektet e mëposhtme:
 - a) shoqatat dhe grupimet e mediave elektronike;
 - b) shoqatat e medias së shkruar;
 - c) profesoratin dhe shoqatat e inxhinierisë elektrike dhe elektronike;
 - ç) profesoratin e së drejtës, gazetari-komunikimit dhe ekonomisë, shoqatat e juristëve dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë;
 - d) organizatat jofitimprurëse që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtave të fëmijëve ose kërkimeve në politikat publike, ose përfaqësues të shoqatave që veprojnë në fushën e mbrojtjes së personave me aftësi të kufizuar.
- III.** Shërbimet e Kuvendit të shpallin dhe të bëjnë publike vakancën në faqen zyrtare të Kuvendit dhe mjetet e informimit publik. Në shpallje të përcaktohet edhe dokumentacioni që duhet të shoqërojë propozimin e kandidaturës nga subjektet e sipërpërmendura, për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve ligjore.

- IV.** Afati i paraqitjes së kandidaturave të propozuara, shoqëruar me dokumentacionin përkatës, përfundon 30 ditë nga data e publikimit të këtij vendimi.
- V.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit.

Zv.KRYETAR

Petro KOÇI